

RRUGA JONË
DREJT SUKSESIT



OUR PATH TOWARD
THE SUCCESS

RAPORT VJETOR **2010**
ANNUAL REPORT

RRUGA JONË DREJT SUKSESIT

1999
Themelimi
i SIGAL

2002
Lider në
tregun e
sigurimeve

2003
FSH.A.N
bëhet
aksioneri i
parë i huaj

2004
Shtrirje në
Maqedoni

2003
Shtrirje
në Kosovë

2006
SIGAL
Risigurime

2005
Sigurimet
e jetës

2007
Pjesë e
UNIQA Group
AUSTRIA

2010
3 tregje
400 punonjës
500 agjentë

Shoqëria
më e mirë e
sigurimeve në
Shqipëri

2010
382 054 Kontrata
34 Milionë € Prime
24 Milionë €
Kapitale të veta
53 Milionë € Asete

Përmbledhje

Contents

06	Harta e mbulimit	Operational area	06
08	Fjala përshëndetëse Z. Andreas Brandstetter, CEO, UNIQA Group Austria dhe Kryetar i Bordit Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Z. Avni Ponari, CEO SIGAL UNIQA Group AUSTRIA	Forewords Z. Andreas Brandstetter, CEO, UNIQA Group Austria & Chairman of Supervisory Board, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Z. Avni Ponari, CEO SIGAL UNIQA Group AUSTRIA	48
11	Rreth kompanisë Strategjia Aksionerët	About the company Strategy Shareholders	51
13	Ngjarje të rëndësishme gjatë 2010-ës Dr. Erhard Busek emërohet Anëtar i Bordit Mbikëqyrës SIGAL merr funksionet e holding për shoqëritë SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni Organizohet në Vjenë Takimi Rajonal Vjetor 2010 Takime të Grupit UNIQA Group Austria mbështet veprimtarinë "Dita Shqiptare në Parlamentin Austriak" Inaugurohet "Klubi i Artit dhe Kulturës i SIGAL" Përgjegjësia sociale	Important events in 2010 Dr. Erhard Busek is appointed Member of the Supervisory Board SIGAL gets holding functions for SIGAL UNIQA companies in Albania, Kosova and Macedonia Takes place in Vienna the 2010 Annual Regional Meeting Group's Meetings UNIQA Group Austria supports the activity "Albanian Day in the Austrian Parliament" Inauguration of "SIGAL Art and Culture Club" Social Responsibility	53
17	Stafi ynë Zhvillojmë burimet njerëzore	Our Staff Developing human resources	57
19	Produkte të reja Super Shëndet Super Kasko Super Servis	New products Super Health Super Casco Super Service	59
23	Të dhëna financiare	Financial Data	63
32	Raporti i Auditit	Audit Report	32
39	Objektivat për 2011	2011 Targets	39

Të dhënat kryesore

**Përforcim i
pozitive në treg**

**Prezantim i
produkteve të
reja**

**Planifikim i shtrirjes
së aktivitetit në
segmentin e jetës
në Kosovë dhe
Maqedoni**

**Rritje e volumit të
primeve mbi rritjen
mesatare të tregut**

“ I fuqishëm dhe i sukseshëm
Rajonal dhe ndërkombëtar
Partneri juaj për sigurimet ”

“ Strong and successful
Regional and international
Your insurance partner ”



	Vëllimi i Primeve 2010	Nr. i Policave deri në 31.12.2010	Nr. i Degëve	Agjentë/ Agjenci	Punonjës 2010
Grupi	34,082,806 Euro	382,054	50	500	400
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA (Jo-Jetë & Risigurime)	16,651,297 Euro	167,702	24	282	221
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA	3,209,566 Euro	23,267	3	21	10
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova	7,501,594 Euro	52,771	6	59	69
UNIQA Maqedoni	6,720,349 Euro	138,314	17	138	100

	Premium Volume 2010	No. of contracts as at 31.12.2010	No. of Branches	Agents/ Agencies	Employees 2010
Group	34,082,806 Euro	382,054	50	500	400
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA (Non- Life & Reinsurance)	16,651,297 Euro	167,702	24	282	221
SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA	3,209,566 Euro	23,267	3	21	10
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova	7,501,594 Euro	52,771	6	59	69
UNIQA Macedonia	6,720,349 Euro	138,314	17	138	100

*Të dashur zonja dhe zotërinj,
Të dashur klientë,
Të dashur partnerë biznesi!*

Pas një viti të vështirë 2009, viti financiar 2010 tregoi shumë zhvillime premtuese dhe të mëdha në ekonominë evropiane dhe atë globale. Pavarësisht këtij tregu ende sfidues UNIQA Group Austria, si një nga kompanitë më të vjetra dhe udhëheqëse të sigurimeve në Evropë arriti të realizojë objektivat e saj ambicioze dhe të ketë rritje domethënëse në 21 vendet evropiane ku operon.

Zbatimi i strategjisë tonë afatgjatë, ndërkombëtarizim i qëndrueshëm dhe rezultate të mira duke mundur shërbim dhe produkte të cilësisë së parë, u realizua përsëri me sukses.

Ashtu si në të kaluarën, edhe në vitin financiar 2010 në rajon ka arritur sërish një rezultat të jashtëzakonshëm në të gjithë Grupin dhe ky është SIGAL UNIQA Group në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë. Bashkëpunimi ndërmjet SIGAL dhe UNIQA Group Austria, si aksioneri i saj më i madh, është bazuar gjithmonë në pozicionimin e SIGAL si lider të vetëm të tregut si dhe në besimin e thellë për të ardhmen pozitive ekonomike të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës.

Duke u bazuar në 200 vitet e përvojës sonë në industrinë evropiane të sigurimeve, në strategjinë tonë të qartë dhe përgjegjësinë e madhe ndaj më shumë se 8 milionë klientëve tanë në 21 vendet evropiane, UNIQA Group Austria do të vazhdojë në mënyrë konsekuente angazhimin tonë të madh ndaj Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës dhe me mbështetjen e madhe të SIGAL UNIQA, stafin e tij drejtues dhe të gjithë punonjësit. Vendimi për të investuar në themelimin e kompanive të reja të sigurimit të jetës në Kosovë dhe Maqedoni është një dëshmi e këtij përkushtimit të UNIQA.



Andreas BRANDSTETTER
CEO, UNIQA Group Austria dhe Kryeta i Bordit Mbikëqyrës
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Ashtu si në të kaluarën, unë do të doja të falënderoj veçanërisht Drejtorin e Përgjithshëm të SIGAL Avni Ponari, që përfaqëson të gjithë drejtimin e SIGAL UNIQA, dhe të gjithë punonjësit, si dhe partnerët tanë të biznesit për suksesin, angazhimin e tyre, përkushtimin dhe kontributin e madh personal për një 2010-të të suksesshme dhe të frytshme.

Vjenë, Qershor 2011

Andreas BRANDSTETTER
CEO, UNIQA Group Austria
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

*Të nderuar klientë, bashkëpunëtorë,
Të dashur punonjës, miq e dashamirës,*

Jam shumë i kënaqur dhe krenar që ndajmë së bashku progresin dhe arritjet e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA gjatë vitit 2010.

Viti 2010 ishte vazhdim i veprimtarisë së suksesshme të SIGAL gjatë të cilit kompanitë e këtij grupi të rëndësishëm financiar në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni patën rezultate pozitive dhe rritje të volumit të primeve mbi rritjet mesatare të tregjeve përkatëse. Grupi SIGAL UNIQA u rrit me 6,14% ndërkohë që tregu në të cilin operon u rrit me rreth 5% (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni).

Në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA që operojnë përkatësisht në fushën e sigurimeve të jo-jetës dhe jetës, patën një rritje mesatare prej rreth 5.09% dhe 11.97%. Ndërkohë patën një rritje të volumit të primeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova me 6.25% dhe UNIQA Maqedoni me 13%.

Gjatë vitit 2010 SIGAL UNIQA përforcoi edhe më shumë pozitën e veta si lideri i tregut shqiptar të sigurimeve në Shqipëri duke zotëruar 30.71% të tregut të sigurimeve jo-jetës dhe 52.19% të tregut të sigurimeve të jetës. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA edhe gjatë këtij viti ka qenë lider në prezantimin e produkteve të reja dhe zhvillimit të tregut.

Gjatë vitit 2010 filluam shtrirjen e aktivitetit të sigurimeve të jetës edhe në Kosovë dhe Maqedoni duke investuar edhe 7 milionë euro. Dy kompani të reja, përkatësisht SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Kosova dhe UNIQA Life Maqedoni kanë finalizuar procedurat e aplikimit dhe do t'i shtohen grupit SIGAL UNIQA duke zgjeruar edhe më shumë gamën e produkteve që do të sjellin në tregun kosovar dhe atë maqedonas të sigurimeve të jetës.

Në vitin që u mbyll filluam gjithashtu procedurat e licencimit për ofrimin e një shërbimi të ri në Shqipëri: pensionet private suplementare. Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA do të sjellë risi dhe shërbim cilësor në tregun e pensioneve suplementare duke u mundur të gjithëve fleksibilitet maksimal në përcaktimin e moshës dhe vlerës së pensionit që duan të përfitojnë.



Avni PONARI
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Me synimin për të qenë gjithmonë e më pranë klientëve tanë, në vitin 2010 prezantuam, produkte të reja në tregun shqiptar të sigurimeve: Super Kasko, Super Shëndet dhe Super Servis. Të quajtura ndryshe 'super produkte sigurimi', produktet e reja kanë si qëllim ofrimin e asistencës maksimale klientëve, kudo ku ndodhen.

Në vitin 2011 SIGAL UNIQA prezantohet me një strukturë të re organizative pas përhithjes së SIGAL Holding nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. Vijimësia e suksesit të SIGAL UNIQA përgjatë 2010-ës konfirmon edhe njëherë largpamësinë e strategjisë sonë e cila fokusohet tek shtrirja e vazhdueshme e aktivitetit, ofrimi i produkteve që kërkon tregu dhe përgjegjshmëria ndaj klientëve.

Me premtimin se SIGAL UNIQA do të jetë gjithmonë një partner i sigurt financiar, shpreh mirënjohjen për të gjithë ata që na shoqërojnë në çdo moment në rrugën tonë. Falënderoj klientët për besimin dhe stafin për përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin.

Tiranë, Qershor 2011

Avni PONARI
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

“ 400 punonjës dhe
500 agjentë në
dispozicionin tuaj! ”



Strategjia



■ Kujdesi ndaj klientit

Shërbimi dhe produktet që ofron SIGAL UNIQA janë të një standardi të lartë, të njëjta me ato që ofrohen në tregjet ndërkombëtare të sigurimeve. Përmes tyre dhe asistencës 24 orë në të gjithë rajonin, klientët tanë marrin përkujdesjen maksimale dhe përgjigje në kohë për çdo nevojë që kanë.

■ Produkte novatore

SIGAL UNIQA ka prezantuar gjithnjë produkte të reja për tregun shqiptar të sigurimeve ndër të cilat Sigurimi Privat i Shëndetit dhe Sigurimi i Jetës me Kursim. Gjatë 2010-ës SIGAL UNIQA solli në treg super-produkte sigurimi të cilat synojnë të afrojnë edhe më shumë publikun shqiptar dhe të rrisin ndërgjegjësimin për domosdoshmërinë e sigurimeve.

■ Rrjet i gjerë rajonal dhe ndërkombëtar

Rrjeti i SIGAL UNIQA prej 400 punonjës dhe 500 agjenci zgjerohet vazhdimisht duke mundur mbulim të plotë jo vetëm në rajon por në të gjithë Europën përmes 40 kompanive UNIQA në mbi 20 shtete europiane.

■ Lider i tregut të sigurimeve

Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA është lider i tregut të sigurimeve në Shqipëri. Përgjatë viteve, SIGAL UNIQA ka pasur rritje më të madhe se rritja mesatare e tregut dhe kjo ka mundur përfundimin e mëtejshëm të pozitave në tregun shqiptar, kosovar dhe maqedonas të sigurimeve.


Aktualisht SIGAL UNIQA zotëron 15.6% të tregut rajonal të sigurimeve.

■ Bashkëpunim me partnerë strategjikë

Gjatë aktivitetit të tij ndër vite SIGAL UNIQA ka zhvilluar edhe më tej marrëdhëniet e biznesit me partnerë të rëndësishëm që operojnë në rajon dhe më gjerë. Institucione të rëndësishme financiare dhe biznese që operojnë në fusha të ndryshme janë ndër klientët dhe bashkëpunëtorët më të mëdhenj të SIGAL UNIQA të cilët kanë mundur mbështetje menaxheriale dhe financiare.

■ Staf profesionistësh

Stafi profesional i SIGAL UNIQA është një ndër faktorët kyç të suksesit. Zhvillimi i mëtejshëm i stafit dhe përmirësimi i njohurive dhe aftësive të tyre është një ndër garancitë për arritjet në të ardhmen.



Aksionerët




■ UNIQA GROUP AUSTRIA

UNIQA Group Austria është aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA pasi zotëron 68.64% të aksioneve të Kompanisë. UNIQA është aksioner i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA që nga muaji Mars i vitit 2007.

UNIQA Group Austria është një nga grupet më të fuqishme financiare në Evropën Qendrore dhe Lindore me një shtrirje të gjerë rajonale pasi operon në 21 tregje evropiane sigurimi përmes 40 kompanive pjesë e grupit UNIQA. UNIQA Group Austria është vlerësuar nga "Standard & Poor's" me "A".

Që nga formimi i saj, UNIQA Group Austria ka përforcuar shpejt pozitën e saj në tregun e sigurimeve vendas dhe atë të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Me rreth 22 000 punonjës, 7.5 milionë klientë dhe 16.5 milionë polica të shitura në 21 shtete, UNIQA është një nga kompanitë më energjike në Evropë.



■ FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDËRMARRJEVE

F.SH.A.N zotëron 13.3% të aksioneve të SIGAL dhe është aksioner i kompanisë që nga Tetori i vitit 2003.


Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995 në kuadër të marrëveshjes "Për Demokracitë e Evropës Lindore". Qëllimi kryesor i F.SH.A.N është të promovojë zhvillimin e ekonomisë duke investuar në një gamë të gjerë biznesesh përmes dhënies së udhëzimeve dhe këshillave lidhur me menaxhimin.

F.SH.A.N drejtohet nga menaxherë profesionistë të investimeve që udhëhiqen nga Bordi i Drejtorëve të cilët emërohen nga Presidenti i SH.B.A-së.

68.64 % UNIQA Group Austria

13.3 % F.SH.A.N

18.06 % Investitorë vendas



Ngjarje të Rëndësishme gjatë vitit 2010



Dr. Erhard Busek, Anëtar i Bordit Mbikëqyrës

■ Erhard Busek emërohet Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Dr. Erhard Busek, Koordinator Special i Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore është emëruar Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Kompanisë.

Dr. Erhard Busek filloi karrierën e tij në vitin 1964 si këshilltar ligjor i Shoqatës së Parlamentarëve dhe më pas u emërua Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Austriake për Tregtinë. Në 1975 u zgjodh Anëtar i Parlamentit Austriak.

Në Prill të vitit 1989 u emërua Ministër i Shkencës dhe Kërkimeve. Nga Maji 1994 deri në Maj 1995 Dr. Busek kishte postin e Ministrit të Edukimit.

Në vitin 1991 Dr. Busek u emërua Zëvendës Kryeministër i Austrisë për periudhën 1991-1995. Që nga Marsi i vitit 2000 deri në Dhjetor të 2001 ishte Përfaqësues Special i Qeverisë Austriake për Zgjerimin e Bashkimit Evropian.

Në Janar të vitit 2002, Dr. Buseku u emërua Koordinator Special i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.

Dr. Busek është Koordinator i Iniciativës Bashkëpunuese të Evropës Jug-Lindore, President i Forumit Evropian Alpbach, Kryetar i Institutit për rajonin e Danubit dhe Evropën Qendrore.



Gjatë ceremonisë së emërimit të Dr. Erhard Busek si Anëtar i Bordit Mbikëqyrës

■ SIGAL UNIQA merr funksionet e Holding për shoqëritë e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Në muajin Nëntor u finalizua bashkimi me përthithje mes SIGAL Holding dhe SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a i cili konsistoi në përqendrimin e kapitalit dhe burimeve njerëzore në shoqërinë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë me qendër në Tiranë SIGAL Holding sh.a i kaluan shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a është një grup shoqërisë që ushtron aktivitet në fushën e sigurimeve të Jetës, Jo-Jetës dhe Risigurimeve nën strukturën e së cilës përfshihen: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA (Jo-Jetë, Shqipëri), SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA (Jetë, Shqipëri), UNIQA a.d (Jo-Jetë, Maqedoni), SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova (Jo-Jetë, Kosovë), SIGAL Risigurime dhe Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA.



Bordi Drejtues gjatë Takimit Rajonal Vjetor në Vjenë



Moment nga Analizat financiare të Grupit

■ Organizohet në Vjenë Takimi Rajonal Vjetor 2010

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, kompania lider e sigurimeve në Shqipëri organizoi në Vjenë Takimin Rajonal Vjetor 2010. Pjesëmarrës në këtë aktivitet të rëndësishëm ishin rreth 200 persona, staf i SIGAL UNIQA nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Mbledhja u organizua në një ndërndërtesat më të veçanta në Vjenë në Pallatin Industrial, në të cilin ndodhen zyrat e Dhomës Austriake të Tregtisë dhe Industrisë.

Takimi u përshëndet veçanërisht nga z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Group Austria, z. Erhard Busek dhe nga personalitete të larta të financave ndërkombëtare.

Vizitat e shumta në muzetë e famshëm të artit dhe kulturës vjeneze të tilla si, Muzeu Ndërkombëtar i Arteve dhe Pallati Todesko ishin mbresëlënëse për stafin e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA. Koha e qëndrimit në Vjenë ka qenë e mbushur me surpriza, falë përgatitjes në detajet më të vogla të stafit austriak të UNIQA-së.

Gjatë 4 ditëve të qëndrimit në Vjenë stafi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA pati mundësinë të njihet nga afër jo vetëm me atraksionet kulturore dhe turistike që ofron kjo kryeqendër evropiane por edhe me punën e madhe, kujdesin dhe përkushtimin për zhvillimin dhe progresin.

■ Takime të Grupit

Takimi Rajonal i stafit drejtues

Në Mars 2010 u zhvillua në Ohër Takimi Rajonal i stafit drejtues të SIGAL UNIQA nga të tre shtetet. Në fokus të takimit ishte analizimi i rezultateve të kompanisë, performanca në tregjet ku operon, planet për 2011 dhe sfidat kryesore për tu kapërcyer. Qëllimi i takimeve rajonale të SIGAL UNIQA është të gjejë zgjidhje për problemet e përbashkëta të kompanive duke analizuar situatat respektive në përputhje me tendencat e tregjeve përkatëse.

Analiza e 9-Mujorit

Në Nëntor 2010 u zhvillua në Durrës Analiza e 9-Mujorit në të cilën morën pjesë drejtues të të gjitha kompanive SIGAL UNIQA, drejtues të departamenteve dhe të mbi 40 degëve. Gjatë takimit u analizuan arritjet e SIGAL UNIQA dhe sfidat më të mëdha për muajt e fundit të vitit. Gjatë periudhës Janar-Shtator 2010 grupi SIGAL UNIQA pati një rritje prej 8.26% në volum primesh në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë duke tejkuluar parashikimet dhe objektivat e vendosura.

Rritja e SIGAL UNIQA, mbi rritjen mesatare të tregut vendas përforcon edhe më shumë pozitën si lider i tregut dhe është një ndër treguesit kryesorë të vizionit të qartë dhe synimit për të kontribuar gjithnjë e më shumë në zhvillimin e tregjeve në të cilat operon.



Parlamenti Austriak

■ UNIQA Group Austria mbështet vempëritarinë "Dita Shqiptare në Parlamentin Austriak"

Më 19 Tetor 2010 u organizua për herë të parë në parlamentin austriak vempëritaria 'Dita Shqiptare' me mbështetjen e aksionerit kryesor të SIGAL UNIQA, njëkohësisht kompanisë më të madhe të sigurimeve në Austri, UNIQA Group Austria.

Gjatë vizitës së delegacionit shqiptar në Austri, i kryesuar nga Kryetarja e Parlamentit Shqiptar, znj. Jozefina Topalli, u hap ekspozita e pikturës me rastin e përvjetorit të lumturimit të shenjtore Nënë Tereza në shenjë nderimi për figurën e kësaj humanisteje shqiptare.

Në ceremoninë solemne e cila u zhvillua në hollin kryesor të Parlamentit Austriak morën pjesë personalitete të larta të jetës politike, ekonomike dhe kulturore të Austrisë dhe të Shqipërisë. Po ashtu të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe miq të ngushtë austriakë që ndër vite kanë mbështetur Shqipërinë dhe shqiptarët.

Në këtë kuadër, UNIQA Group Austria e cila përfaqëson një ndër investimet e para dhe më të mëdha austriake në Shqipëri, mbështeti aktivitetin synimi i të cilit ishte përforcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ekonomik, politik dhe kulturor midis Shqipërisë dhe Austrisë.



Z. Avni Ponari dhe z. Vangjush Dako, Kryetari i Bashkisë së Durrësit gjatë inaugurimit

■ Inaugurohet Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA inauguroi në muajin Nëntor, të parin dhe të vetmin Klub Arti në qytetin e Durrësit. Klubi i Artit dhe Kulturës është vendi ideal për të gjithë adhuruesit e letërsisë, muzikës, arteve pamore si dhe për të gjithë ata që pëlqejnë të marrin njëkohësisht dozën e tyre të kafes dhe informacionit kulturor në një ambient artistikisht të këndshëm.

Klubi i Artit dhe Kulturës i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është vendosur jo pa qëllim në qendër të Durrësit: në Rrugën Tregtare, një zonë e cila për nga vetë pozicionimi i saj ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe rrjedhimisht edhe në atë kulturor dhe social të qytetit bregdetar.

Kjo qendër e re është një shtëpi libri, një galeri arti dhe sallë muzike; thënë ndryshe një vend që mbledh të tre artet në një dhe ju jep mundësinë e kalimit të orëve sa çlodhëse aq edhe informuese mbi emrat e rinj dhe punët më të fundit të artistëve shqiptarë dhe të huaj. Ai synon të promovojë artin dhe kulturën bashkëkohore shqiptare përmes prezantimeve të titujve të rinj të letërsisë shqiptare dhe asaj të huaj, eventeve muzikore dhe ekspozitave të shumta të artistëve të artit pamor. Në këtë mënyrë, Klubi i Artit dhe Kulturës do të kontribuojë në edukimin e mëtejshëm të publikut të gjerë me risitë kulturore në Durrës dhe në të gjithë Shqipërinë.



Z. Ponari me basketbollistët e ekipit Prishtina

Përgjegjësia sociale

Komuniteti

Aktiviteti siguroes i SIGAL UNIQA ka si synim ofrimin e një stabiliteti financiar për të gjithë komunitetin dhe kjo është një ndër mënyrat se si ne e zbatojmë përgjegjësinë tonë sociale. Në këtë kuadër SIGAL UNIQA kujdeset që t'i përgjigjet në kohë klientëve veçanërisht duke paguar shpejt dëmet. Gjithashtu, me synimin për të kontribuar edhe në zhvillimin kulturor dhe social SIGAL UNIQA mbështet aktivitete të shumta kulturore dhe sportive. Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA mbështet vazhdimisht aktivitete të cilat synojnë promovimin e letërsisë, arteve pamore dhe muzikës ndër të cilat 'Mbrëmja gala për Nënë Terezën' si dhe është sponsor i përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe i disa skuadrave sportive të tilla si skuadra e basketbollit Prishtina.

Shëndeti dhe siguria

Duke synuar një shëndet më të mirë, SIGAL UNIQA prezantoi i pari Sigurimin Privat të Shëndetit fokusi i të cilit është identifikimi i hershëm i sëmundjeve dhe parandalimi në kohë të tyre. Rreth 10 000 njerëz kanë një kartë sigurimi shëndeti tek SIGAL UNIQA dhe përfitojnë shërbim mjekësor cilësor në një rrjet të gjerë ndërkombëtar klinikash dhe spitalesh.

Nën sloganin 'Shëndeti vjen i pari' SIGAL UNIQA hapi të parin dhe të vetmin Klub Shëndeti në Shqipëri në të cilin mundësohen ekzaminime falas

të gjendjes fizike dhe shëndetësore për klientët e SIGAL UNIQA.

Drejtimi

Standardet tona të punës janë ndërtuar mbi bazën e ligjeve duke i zbatuar me përpikmëri ato, duke u treguar korrektë me klientët, partnerët tanë të biznesit dhe punonjësit. Ne mendojmë se angazhimi ynë për përgjegjësinë sociale do të thotë gjithashtu përkushtim i thellë për mirëqenien.

Iniciativa ligjore

Falë përvojës sonë si një ndër kompanitë e para që hyri në tregun shqiptar të sigurimeve, ne kemi ndikuar në zhvillimin e mëtejshëm të legjislacionit mbi sigurimet. Përmes këtij impakti, së bashku me aktorët e tjerë të fushës, kemi mundur një treg që ofron produktet për të cilat ka nevojë klienti si dhe një shërbim në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Investime

SIGAL UNIQA ka investuar në zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit me partnerë të cilët ofrojnë shërbim dhe produkte të standardeve të larta duke kontribuar në këtë mënyrë, të gjithë së bashku në zhvillimin e mëtejshëm të komunitetit dhe ekonomisë.

Stafi ynë



Stafi SIGAL UNIQA duke marrë pjesë në trajnime



Akademia e Drejtuesve UNIQA Group Austria

Zhvillojmë burimet njerëzore

Progresi i arritur deri më tani është fryt i punës së mbi 400 punonjësve dhe 500 agentëve të rrjetit të SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Përkushtimi dhe ambicia e stafit tonë për tu ofruar një shërbim të shkëlqyer klientëve na kanë çuar drejt suksesit. Ne i kushtojmë një rëndësi të veçantë forcimit të lidershit dhe zhvillimit personal duke nxitur potencialin e çdo punonjësi.

Duke pasur si synim kryesor të jemi partnerë të besueshëm për klientët tanë, i kushtohet një vëmendje të veçantë trajnimit të vazhdueshëm të stafit, promovimit të tij dhe rritjes së mëtejshëm të profesionalizmit.

Numri në rritje i punonjësve të rinj ka shpresuar ciklet e trajnimeve bazë për konceptet kyçe të industrisë së sigurimeve, produktet e sigurimit, proëdurën e marrjes në sigurim dhe procedurat e trajtimit të dëmeve.

Gjatë vitit 2010, janë mundur trajnime si brenda ashtu edhe jashtë vendit në institucione partnere ndërkombëtare të mirënjohura në tregun ndërkombëtar të sigurimeve me synim përmirësimin e aftësive dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Pjesa më e madhe e orëve të trajnimit të stafit të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA i është kushtuar zhvillimit të aftësive të shitjeve dhe njohurive për produktet dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimit për klientët.

Në fokus të trajnimeve dhe seminareve kanë qenë agjentët, stafi i shitjes dhe marrëdhënieve me klientët dhe menaxherët e produkteve.

Akademia e Drejtuesve

Akademia e Drejtuesve e cila organizohet në Austri nga UNIQA Group Austria, është një ndër programet më të rëndësishme të trajnimeve. Akademia e Drejtuesve synon përmirësimin e ekspertizës strategjike të drejtuesve dhe rritjen e efikasitetit përmes kombinimit të trajnimit dhe shkëmbimit të eksperiencës së drejtuesve të departamenteve të ndryshme në të gjitha kompanitë e Grupit. Akademia e Drejtuesve ndihmon në këtë mënyrë në formimin e ekipeve drejtuese të kompanive UNIQA në të gjithë rajonin ku operon, me të njëjtin standard të lartë.

BOTA E SIGAL UNIQA Group AUSTRIA



Produkte të reja

Gjatë vitit 2010 SIGAL ka zgjeruar edhe më shumë gamën e produkteve që ofron duke prezantuar produkte unike sigurimi të tilla si Super Shëndet, Super Kasko dhe Super Servis. Të kombinuara kryesisht me sigurimin e automjetit, këto produkte synojnë afrimin e mëtejshëm të publikut me sigurimet.

■ SUPERSHËNDET

Është një paketë sigurimi i cili vjen si një kombinim i sigurimit privat të shëndetit me sigurimin e makinës. Duke u pajisur me një Super Shëndet nga SIGAL UNIQA klientët përfitojnë sigurimin e automjetit dhe shërbime mjekësore në të gjitha klinikat dhe spitalet private më të mira brenda dhe jashtë Shqipërisë (sipas kërkesës).

Super Shëndet mbulon:

- Dëmshpërblim në rast aksidenti: 1 milion lekë;
- Kontrollë rutinë (gjak+urinë komplet, bilirubinë, lipidogramë, glicemi): 1 herë/vit
- Trajtim spitalor në rast sëmundjeje deri në: 250,000 lekë/vit
- Trajtim spitalor në rast aksidenti deri në: 250,000 lekë/vit
- Kirurgji ditore në rast aksidenti deri në: 50,000 lekë/vit
- Ekzaminime imazherike MRI, CT, PET deri në: 50,000 lekë/vit
- Ilace te rekomanduara: 20,000 lekë/vit
- Transport me ambulancë

Gjithashtu, çdokush i pajisur me një policë SuperShëndet përfiton automatikisht ekzaminime falas në të parin dhe të vetmin Klub Shëndeti në Shqipëri "SIGAL VitalClub" në City Park.

■ SUPER KASKO

Është sigurimi i vetë automjetit për dëmtimet materiale të automjetit nga përplasja e tij me një automjet tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar me proces verbalin e policisë.

SIGAL UNIQA vlerëson dëmin e automjetit dhe

klienti do të dëmshpërblehet menjëherë pa patur nevojë të presë dëmshpërblimin e kompanisë përgjegjëse.

Sigurimi SUPER KASKO mbulon shpenzimet për riparimin e automjetit të dëmtuar si pasojë e një aksidenti me një automjet tjetër pavarësisht se kush është fajtori. Nëse klienti nuk është shkaktar i aksidentit dhe nuk pranon fajësinë, atëherë polica e sigurimit do të vazhdojë të jetë e vlefshme duke e mbrojtur nga aksidente të tjera që mund të ndodhin.

■ SUPER SERVIS

Është sigurimi i automjetit nga aksidentet, difektet, zjarri, tentativave për vjedhje dhe akteve keqdashëse. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ju mundëson asistencë maksimale në rast se automjeti juaj nuk është në gjendje pune gjatë udhëtimit tuaj. Duke njoftuar SIGAL UNIQA, ju përfitoni asistencë të menjëhershme në të gjithë Shqipërinë: riparim në servis, shërbim karroatrec dhe mbulim shpenzimesh të tjera.

Përmes produktit Super Servis, klienti përfiton:

- Shërbim me karroatrec: për në servis më të afërt të autorizuar;
- Automjet tjetër në dispozicion gjatë kohës së riparimit: në rastet kur automjeti nuk mund të riparohet brenda një dite pune;
- Mbulim të shpenzimeve për akomodim në hotel nëse mjeti nuk mund të riparohet brenda një dite pune në servis e autorizuar;
- Mbulimi i shpenzimeve për ruajtjen në parking të automjetit: në rastet kur nuk mund të riparohet brenda një ditë pune në servis dhe nuk mund të transportohet në servis e autorizuar dhe duhet të ruhet derisa të mundësohet transportimi.

“ Menaxhim, koordinim, përvojë,
profesionalizëm, përgjegjësi ”





Stafi drejtues i kompanive SIGAL UNIQA Group AUSTRIA
Shqipëri, Kosovë, Maqedoni

GRUPI

Të ardhura vjetore nga primet e GRUPIT (në Euro)

	2008	2009	2010
TOTAL	27,498,016	32,093,698	34,082,806
Shqipëri	15,996,211	19,113,993	19,860,863
Kosovë	6,085,366	7,060,838	7,501,594
Maqedoni	5,416,439	5,918,867	6,720,349




SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Shqipëri Jo - Jetë

Tregu shqiptar i sigurimeve të jo - jetës

Sipas raportit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2010 në tregun shqiptar të sigurimeve të jo-jetës kanë ushtruar aktivitetin e tyre 8 kompani.

Tregu është udhëhequr nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo-jetë Shqipëri me 30.71% të vëllimit të përgjithshëm të primeve.





Dëme të paguara për vitin 2010

Sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në tregun shqiptar të sigurimeve jo-jetë janë paguar rreth 2.2 Miliardë lekë dëme (33.78% më shumë se në vitin 2009), nga të cilat 28.53% janë paguar nga

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo-Jetë. Pjesa tjetër e dëmeve janë paguar nga 7 kompanitë e tjera që operojnë në këtë treg.

Të ardhura vjetore nga primet SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo Jetë Shqipëri (në Euro)

	2008	2009	2010
TOTAL	14,294,632	16,205,254	16,651,297
AP dhe Shëndet	817,550	990,453	1,427,787
MTPPL	7,655,352	7,655,568	7,671,244
KASKO	1,114,780	1,446,481	1,469,444
Marinë dhe Aviacion	673,465	1,970,943	1,690,626
Pasuri dhe Përgjegjësi	3,358,229	3,472,248	3,932,214
Garanci	675,256	669,561	459,981




SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA

Tregu shqiptar i sigurimeve të jetës

Bazuar në të dhënat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA ka qenë sërish lider i tregut të sigurimeve të jetës në të cilin operojnë 3 kompani.

SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA ka udhëhequr këtë treg me 52.19% të vëllimit të përgjithshëm të primeve.





Dëme të paguara për vitin 2010

Sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës janë paguar rreth 71.9 Milionë lekë dëme, nga të cilat 44.86%

janë paguar nga SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA. Pjesa tjetër e dëmeve janë paguar nga 2 kompanitë e tjera që operojnë në këtë treg.

Të ardhura vjetore nga primet SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA (në Euro)

	2008	2009	2010
TOTAL	1,701,579	3,008,739	3,209,566
Sigurimi i Jetës për Hua	1,650,801	2,359,245	2,409,038
Sigurim i Kombinuar i Jetës	50,778	103,181	110,953
Sigurimi i Jetës me Kursim	0	546,313	689,575




SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova

Tregu kosovar i sigurimeve

Bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2010 në tregun kosovar të sigurimeve të jo-jetës kanë ushtruar aktivitetin e tyre 10 kompani sigurimi jo-jete.

Gjatë vitit 2010 SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova u pozicionua e treta në treg duke zotëruar 12.56% të tij për primet e shkruara.





Dëme të paguara për vitin 2010

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në tregun kosovar të sigurimeve jo-jetë janë paguar rreth 22

Milionë Euro dëme, nga të cilat 10.72% janë paguar nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova.

Të ardhura vjetore nga primet SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova (në Euro)

	2008	2009	2010
TOTAL	6,085,366	7,060,838	7,501,594
AP dhe Shëndet	197,081	593,410	828,349
Motorike	5,214,876	5,403,751	5,640,163
Marinë dhe Aviacion	7,500	13,809	16,975
Pasuri dhe Përgjegjësi	305,237	641,902	795,071
Garanci	360,672	407,966	221,036




UNIQA Maqedoni

Tregu maqedonas i sigurimeve

Sipas Agjencisë Mbikëqyrëse të Sigurimit, gjatë vitit 2010 në tregun maqedonas të sigurimeve të jo jetës kanë ushtruar aktivitetin 11 kompani sigurimi jo-jetë.

UNIQA a.d ka përforcuar pozitën në këtë treg duke zotëruar 6.72% të tij për nga primet e shkruara.





Dëme të paguara për vitin 2010

Sipas Agjencisë Mbikëqyrëse të Sigurimit, në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës janë paguar


rreth 2.93 Miliardë Denar dëme, nga të cilat 7.4% janë paguar nga UNIQA Maqedoni.

Të ardhura vjetore nga primet UNIQA Maqedoni (në Euro)


	2008	2009	2010
TOTAL	5,416,439	5,918,867	6,720,349
AP dhe Shëndet	279,788	512,961	667,184
Motorike	4,660,465	4,766,765	5,296,739
Marinë dhe Aviacion	12,684	16,352	38,595
Pasuri dhe Përgjegjësi	463,502	622,789	717,831



Numri i punonjësve/ number of employees



Numri i agjentëve / number of agents



Të ardhura vjetore nga primet (në Euro) / annual premiums (in Euro)



Të dhëna Financiare

32 Raport i Pavarur i Auditit

34 Pasqyra e Pozicionit Financiar

35 Pasqyra Përmbledhëse e të Ardhurave

36 Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

38 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

39 Parashikimet 2011

Financial Data

33 Independent Auditor's Report

34 Consolidated Statement of Financial Position

35 Consolidated Statement of Comprehensive Income

36 Consolidated Statement of Changes in Equity

38 Consolidated Statement of Cash Flows

39 2011 Forecast

Raport i Pavarur i Auditit

Drejtuar aksionerëve dhe drejtuesve të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a (Grupi), të cilat përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2010 dhe pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit, dhe pasqyrën e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtuesve për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për një kontroll të tillë të brendshëm për të cilin Drejtimi e mendon se është i nevojshëm për të përgatitur pasqyrat e konsoliduara financiare pa pasaktësira materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimet.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësira materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut për pasaktësira materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi riskun, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi të përshatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin dhe përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkangjitur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Grupit më 31 Dhjetor 2010, rezultatin financiar dhe fluksin e parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Albania Shpk

Tiranë, Shqipëri
13 Maj 2011

Independent Auditor's Report

To the shareholders and management of SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a:

We have audited the accompanying consolidated financial statements of SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a (the "Group"), which comprise the statement of financial position as at December 31, 2010, and the statement of comprehensive income, statement of changes in equity and statement of cash flows for the year then ended, and a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.

Management's Responsibility for the Consolidated Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these consolidated financial statements in accordance with International Reporting Standards and for such internal control as management determines is necessary to enable the preparation of consolidated financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error.

Auditor's Responsibility:

Our responsibility is to express an opinion on these consolidated financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the consolidated financial statements are free from material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the consolidated financial statements. The procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the consolidated financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the consolidated financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the consolidated financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

Opinion

In our opinion, the accompanying consolidated financial statement present fairly, in all material respects, the financial position of the Group as of December 31, 2010, its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with International Financial Reporting Standards.

Deloitte Albania Shpk

Tirana, Albania
May 13, 2011

Pasqyra e Pozicionit Financiar Consolidated Statement of Financial Position

deri në 31 Dhjetor 2010 / as at December 31, 2010

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated))

	Shënime / Notes	deri në 31 Dhjetor / As at December 31 2010	deri në 31 Dhjetor 2009 "rideklaruar" / As at December 31, 2009 "restated"
AKTIVET	ASSETS		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	Property, plant and equipment	4 958,116	920,861
Aktive afatgjata të mbajtura për shitje	Non-current assets held for sale	5 65,494	-
Aktive financiare	Financial assets	6 3,808,067	3,466,521
Arkëtimi nga sigurimet	Insurance receivables	7 781,584	765,578
Aktive të tjera	Other assets	53,256	51,512
Inventari	Inventory	8 6,790	7,317
Kontrata risigurimi	Reinsurance contracts	9 67,904	157,757
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	Deferred acquisition costs*	405,702	335,631
Taksa fitimi i parapaguar	Repaid income tax	10 9,253	1,576
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	Cash and cash equivalents	11 1,364,206	281,752
TOTALI I AKTIVEVE	TOTAL ASSETS	7,520,372	5,988,505
KAPITALI	EQUITY		
Kapitali aksioner	Ordinary shares	12 2,232,909	1,241,830
Rezerva të tjera të kapitalit	Other capital reserves	13 52,133	76,804
Rezervat ligjore	Legal reserve	14 261,600	190,647
Diferenca rivlerësimit	Translation reserves	15 96,998	95,526
Fitimi i mbartur	Retained earnings	640,259	666,239
Totali i kapitalit në ngarkim të aksionerëve kryesorë të kompanisë	Total equity attributable to the Company's equity holders	3,283,899	2,271,046
Aksionerë të tjerë	Non-controlling Interest	45	65
TOTALI I KAPITALIT	TOTAL EQUITY	3,283,944	2,271,111
DETYRIMET	LIABILITIES		
Kontrata sigurimi	Insurance contracts*	16 3,845,815	3,358,628
Tregtia dhe pagesa të tjera	Trade and other payables	18 379,060	343,756
Pagesat nga aktiviteti risiguroes	Payables from reinsurance activity	19 150,213	15,010
Hua	Borrowings	17 1,340	-
TOTALI I DETYRIMEVE	TOTAL LIABILITIES	4,236,428	3,717,394
KAPITALI DHE DETYRIMET TOTALE	TOTAL EQUITY AND LIABILITIES	7,520,372	5,988,505

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtorët e Grupit më 30 Prill 2011 dhe nënshkruar nga:
These consolidated financial statement have been approved by the Directors of the Group on April 30, 2011 and signed on its behalf by:


Avni PONARI
Drejtor i Përgjithshëm
CEO


Klement MERSINI
Drejtor i departamentit të Financës
Director of Financial Department

Pasqyra Përmbledhëse e të Ardhurave Consolidated Statement of Comprehensive Income

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010 / for the year ended December 31, 2010

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated))

	Shënime / Notes	deri në 31 Dhjetor 2010 / For the year ended December 31, 2010	për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 For the year ended December 31, 2009 *restated
Të ardhura nga primet	Insurance premium revenue *	20 4,333,418	3,733,878
Prime të çeduar në risigurim	Insurance premium ceded to reinsurers	20 (804,277)	(470,988)
Të ardhura neto nga primet	Net insurance premium revenue	3,529,141	3,262,890
Të ardhura nga investimet	Investment income	150,222	140,853
Të ardhura të tjera operative	Other operating income	21 79,893	48,276
Të ardhura neto	Net income	3,759,256	3,452,019
Fitimi neto nga sigurimet dhe dëmet	Net insurance benefits and claims	22 (1,661,296)	(1,593,810)
Kosto e marrjes në sigurim*	Acquisition costs*	23 (574,012)	(435,163)
Shpenzime administrative dhe marketing	Expenses for marketing and administration	24 (1,187,870)	(1,026,601)
Shpenzime të tjera operative	Other operating expenses	25 (251,148)	(303,721)
Shpenzimet	Expenses	(3,674,326)	(3,359,296)
Rezultate të aktiviteteve operative	Results of operating activities	84,930	92,724
Fitime nga kursi i këmbimit	Foreign exchange gain	95,101	179,640
Fitimi para tatimit	Profit before tax	180,031	272,364
Tatim fitimi	Income tax expense	26 (35,352)	(46,687)
Fitimi i vitit	Profit for the year	144,679	225,677
Të ardhura të tjera të përfshira	Other comprehensive income	3,747	110,749
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit	Total comprehensive income for the year	148,426	336,426
Fitimi në ngarkim të:	Profit attributable to:		
Aksionerëve kryesorë	Equity holders of the parent	144,672	225,646
Aksionerëve të tjerë	Non-controlling interest	7	31

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital Consolidated Statement of Changes in Equity

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010 / for the year ended December 31,
2010

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated)

		Kapitali aksioner	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezervat ligjore	Korrigjimet e transfertave	Fitimi i mbartur	Në ngarkim të aksionerëve kryesorë	Aksionerë të tjerë	TOTALI
		Ordinary shares	Other capital reserves	Legal Reserve	Translation adjustment	Retained earnings	Attributable to equity holders of the parent	Noncontrolling interest	Total
Deri në 31 Dhjetor, 2008	As at December 31, 2008	1,241,830	68,708	43,163	338	930,993	2,285,032	34	2,285,066
<i>Përvetësimi i fitimit të mbartur</i>	<i>Appropriation of retained earnings</i>	-	7,732	141,571	-	(149,303)	-	-	-
<i>Fitimi i vitit</i>	<i>Profit for the year</i>	-	-	-	-	225,646	225,646	31	225,677
<i>Shpërndarja e dividendit</i>	<i>Dividend distribution</i>	-	-	-	-	(350,381)	(350,381)	-	(350,381)
<i>Të ardhura të tjera përmbledhëse</i>	<i>Other comprehensive income</i>	-	364	5,913	95,188	9,284	110,749	-	110,749
Deri në 31 Dhjetor, 2009	As at December 31, 2009	1,241,830	76,804	190,647	95,526	666,239	2,271,046	65	2,271,111
<i>Rritje e përqindjes së kapitalit</i>	<i>Share capital increase</i>	974,119	-	-	-	-	974,119	-	974,119
<i>Rritje e rezervave ligjore</i>	<i>Increase of legal reserves</i>	-	-	60,974	-	(60,974)	-	-	-
<i>Përvetësim i rezervave</i>	<i>Appropriation of reserves</i>	16,960	(24,307)	9,949	(2,602)	-	-	-	-
<i>Fitimi i vitit</i>	<i>Profit for the year</i>	-	-	-	-	144,679	144,672	7	144,679
<i>Shpërndarja e dividendit</i>	<i>Dividend distribution</i>	-	-	-	-	(109,685)	(109,685)	-	(109,685)
<i>Rënie e zotërimit të aksionerëve të tjerë</i>	<i>Non controlling interest share decrease</i>	-	-	-	-	-	-	(27)	(27)
<i>Të ardhura të tjera përmbledhëse</i>	<i>Other comprehensive income</i>	-	(364)	30	4,074	-	3,747	-	3,747
Deri në 31 Dhjetor, 2010	As at December 31, 2010	2,232,909	52,133	261,600	95,526	640,259	3,283,899	45	3,283,944

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë Consolidated Statement of Cash Flows

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010 / for the year ended December 31, 2010

(të gjitha shifrat janë në mijë ('000) LEKË, me përjashtim të rasteve të specifikuara
(all amounts are expressed in thousand ALL, unless otherwise stated)

	deri në 31 Dhjetor 2010/ For the year ended December 31, 2010	për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 For the year ended December 31, 2009
Rrjedha e parasë gjatë aktiviteteve operative	Cash flows from operating activities	
Fitimi para tatimit	Profit before income tax expense	180,031
Rregullimet për të barazuar fitimin neto me rrjedhën neto të parasë nga aktivitetet operative	Adjustments to reconcile net profit to net cash flows from operating activities:	
Zhvlërësimi	Depreciation	88,803
Ndryshime në rezervat e kontratave të sigurimit	Change in insurance contract provisions	487,186
Fitimi nga shitja e pasurisë	Gain on sale of property	(579)
Ndryshime në rezervat e kontratave të risigurimit	Change in reinsurance contract provisions	89,853
Detyrimet nga dëmtimet	Impairment charge	64,079
Të ardhurat nga interesi	Interest income	(150,222)
Ndikimi i transferimit	Translation effect	(25,119)
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ përpara ndryshimeve në aktivitet dhe detyrimet operative	Cash flows from operating profits before changes in operating assets and liabilities	734,032
Rritja në sigurimet që janë për t'u marrë	Increase in insurance receivables	(64,062)
Rënia në inventar	Decrease in inventory	527
Rritja në aktive të tjera	Increase in other assets	(1,745)
